



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 153, Datë 17.07.2025

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 2” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, dhe 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1496/10 prot., datë 11.07.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPV BLUE 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1496 prot., datë 10.04.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1496/1 prot., datë 15.04.2025, ka depozituar mandatin për kryerjen e pagesës së aplikimit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 83, datë 24.04.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.04.2025 dhe 26.04.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.04.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1496/4 prot., datë 30.04.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim, duke evidentuar dhe informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me ERE-n në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar, ka rezultuar se është plotësuar një pjesë e këtij dokumentacioni dhe me e-mailin e datës 15.05.2025, protokolluar në ERE me nr. 1497/6 prot., datë 19.05.2025, shoqëria ka kërkuar disa ditë kohë për depozitimin e dokumentacionit të mbështetjes financiare.
- Në këto rrethana, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 104, datë 23.05.2025, u vendos të zgjatet deri në 30 ditë afati i vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 2” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1497/9 prot., datë 03.06.2025, rezulton se shoqëria ka dorëzuar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit, përmes shkresës së protokolluar me nr. 1497/8 prot., datë 03.06.2025, nga shqyrtimi i të cilit u vlerësua se mbetej ende për t'u sqaruar çështja e strukturës organizative, mbështetja financiare për ushtrimin e veprimtarisë dhe disponimi i zyrave përfaqësuese të furnizuesit.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 126, datë 24.06.2025, u vendos zgjatja e vendimmarrjes me 30 (tridhjetë) ditë, për t'i dhënë mundësinë shoqërisë që të depozitojë këtë dokumentacion.
- Me shkresën nr. 1497/12 prot., datë 01.07.2025, u njoftua shoqëria për zhvillimin e një seance dëgjimore, për të sqaruar dokumentacion përkatës. Pas diskutimeve të zhvilluara në seancën e mbajtur në datën 07.07.2025, në ambientet e ERE-s, me përfaqësuesin e shoqërisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1497/13 prot., datë 07.07.2025, shoqëria ka depozituar dhe dokumentacionin e kërkuar.

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Aneksi A i “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Në referencë të përcaktimeve të Rregullores, aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 9, pika 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; pika 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pika 2.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k., OST sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI